



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. EXLP prot.

Tepelenë, më 28 . 07 . 2025

Lënda: Raportim i punës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike në lidhje me “Masat e marra për ruajtjen dhe zgjerimin e hapësirave të gjelbëruara në qytet si dhe grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve urbane sipas standarteve të lejuara, masat që janë marrë për sistemimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve dhe atyre publike në Bashkinë Tepelenë”, në përgjigje të shkresës nr.14/07, datë 14.07.2025 të Këshillit Bashkiak Tepelenë.

Drejtuar:

KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË.

Sheshi “Lord Bajron”, Tepelenë.

Për dijeni:

KRYETARE E BASHKISË TEPELENË.

Sheshi “Lord Bajron”, Tepelenë.

Drejtoria e Shërbimeve Publike kryen funksionin e saj si pjesë e strukturës së Bashkisë Tepelenë në mbështetje të Vendimit nr.08, datë 27.01.2023 “Për miratim të rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës Bashkia Tepelenë”; Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligjit 8094/1996 “Për largimin publik të mbetjeve”; Ligjit 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”; Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; Ligjit 10462/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”; VKM 175/201 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”; Ligjit 8308/1998 “Për transportet rrugore”; Ligjit 8402/1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”; Ligjit 9220/2004 “Për shërbimin publik të varrimit” etj.

Drejtoria e Shërbimeve Publike ofron shërbimin në të 4 Njësitë Administrative Tepelenë, Qendër Tepelenë, Kurvelesh dhe Lopës duke përfshirë qytetin Tepelenë, rrethinat dhe 24 fshatra të shpërndarë në një territor prej 431 km² në terren kryesisht malor dhe kodrinor duke mbuluar këto shërbime:



- Pastrim dhe mirëmbajtje e hapësirave publike nga mbetjet urbane, pastrim i venddepozitimeve dhe pastrim i akseve rrugore, pastrim nga vegjetacioni i rugeve të brendshme dhe pastrim i kanaleve vadites.
- Grumbullim i mbetjeve urbane, mbetjeve inerte, mbetjeve voluminoze.
- Mirëmbajtje e rrugëve, ndërtimtaria dhe rikonstruksioni i tyre.
- Shërbim publik i varrimit.
- Gjelbërim- dekor dhe mbarëvajtje e hapësirave të gjelbëruara, lulishteve dhe parqeve publik, mobilimi urban i territorit.
- Ndricim publik, mirëmbajtja e rrjetit rrugor të ndricimit publik në të gjithë Bashkinë Tepelenë.
- Mirëmbajtje e aseteve publike godinat në pronësi ose përdorim të Bashkisë Tepelenë, institucione shkollore, varrezat publike dhe varrezat e dëshmorëve, asetet publike monumente, memoriale, buste, shatërvane dhe cdo pronë dhe aset të Bashkisë Tepelenë.

1. Pastrimi i territorit, hapësirave publike dhe akseve rrugore dhe grumbullimi i mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Tepelenë.

Procesi i shërbimit të pastrimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave publike dhe akseve rrugore është procesi më i rëndësishëm i shërbimeve nga ku i është kushtuar më shumë kohë dhe burime njerëzore për tu kryer në standarte të larta. Brigada e pastrimit të Njësisë Administrative Tepelenë kryen shërbimin e pastrimit nga mbetjet urbane në një territor prej **1 km²** të qytetit Tepelenë dhe rrethinave në përditshmëri sipas një plani pune të përcaktuar për cdo punonjës. Në vijimësi të mbarëvajtjes së hapësirave publike dhe aksioneve të pandërprerë të pastrimit kemi bërë të mundur kontrollin **100%** të territorit në këtë njësi administrative duke eliminuar të gjithë vendgrumbullimet e mbetjeve urbane në lagje, rrethina dhe zona turistike nga ku përmendim:

- Eliminimi i vendgrumbullimit në lagjen “Demokracia”.
- Eliminimi i vendgrumbullimit në lagjen “Fermë”.
- Eliminimi i vendgrumbullimit në “Skarpatën e kalasë së qytetit”, pjesa veriore dhe pjesa lindore.
- Eliminimi i vendgrumbullimit në skarpatën e rrugës “Unaza Veriore”.
- Eliminimi i vendgrumbullimeve të vogla të trajtuara më parë në lagjet “Mustafa Matohiti(pas muzeut), L.Majkosh, L.Selam Musai.



Mbarëvajtja e këtyre ambienteve është kryer në përditshmëri me një punë të shtuar nga ana e shërbimeve duke mos lejuar rikrijimin e vendgrumbullimeve të cilat krijohen nga persona të papërgjegjshëm që shkelin ligjin duke kryer krim mjedisor në mënyrë të përsëritur në të gjithë territorin e Bashkisë Tepelenë. Në planin e punës në vijimësi të punëve sezonale kryejmë gëlqerizim dhe pastrim vegetacioni nga rrugët e brendshme në të gjithë territorin e njësive Tepelenë, duke përfshirë lyerje dhe trajtim të pemëve, bordurave dhe rrugëve të qytetit. Gjithashtu në nisje të sezoni veror kryhet rregullisht klorizimi i kontenierëve, vendqëndrimit të tyre dhe pusetave të ujërave të zeza në të gjithë territorin e Bashkisë Tepelenë. Në njësinë administrative Qendër Tepelenë e cila mbulon një territor të gjerë kemi punuar në vijimësi të mirëmbajtjes dhe ruajtjes së hapësirave publike nga ndotja duke eliminuar një sërë vendgrumbullimesh por për shkak të frekuencës së lartë të ndotjes kemi bërë të mundur eliminimin në masën **70%** të vendgrumbullimeve ku përfshihet fshati : Dukaj, Lekël, Velipot, Turan dhe Luzat (Uji i Ftohtë Tepelenë). Kemi planifikuar ndërhyrje në fshatin Bence, Lagjen Kordhaj Dukaj dhe në fshatin Hormovë.

Në njësitë administrative Lopës dhe Kurvelesh pastrimi i ambienteve publike kryhet nga brigadat e shërbimeve të lokalizuara në njësi në mbikqyrje nga Administratori i Njësive Administrative.

Pjesë e planit të punës është dhe pastrimi i akseve rrugore nga mbetjet urbane në të gjithë gjatësinë e tyre në territorin që administron Bashkia Tepelenë dhe përkatësisht:

- Aksi Rrune-Subash(13km) I rrugës nacionale Sh4; frekuenca e pastrimit 1ditë/javë.
- Aksi Urë e Leklit-Mezhgoran(15km) I rrugës nacionale Sh75; frekuenca e pastrimit 1ditë/javë.
- Rruga Tepelenë-Dukaj(9,7km); frekuenca e pastrimit 1ditë/javë.
- Rruga Tepelenë-Bëncë(6km); frekuenca e pastrimit 1ditë/javë.
- Rruga Progonat-Gusmar(6,3km); frekuenca e pastrimit 3ditë/muaj.
- Rruga Dukaj-Salari-Kurvelesh (20km); frekuenca e pastrimit 1ditë/javë.
- Rruga Dukaj-Sinanaj(19km); frekuenca e pastrimit 1ditë/javë.

Pastrimi i zonave turistike si Uji i Ftohtë Tepelenë dhe Kalaja e Tepelenës kryet në përditshmëri nga punonjësit tanë.

Brigadat tona mbulojnë dhe pastrimin e territorit nga mbetjet inerte, mbetjet voluminoze dhe mbetjet e krijuara nga proceset e gjelbërimit (korreje, krasitje) të cilat trajtohen nga punonjësit tanë në të gjithë territorin e njësive administrative.

Pjesë e planit të punës në njësi është dhe pastrimi nga vegetacioni i rrugëve të fshatrave, korreja dhe prerja e ferrave dhe shkurreve, pastrimi i akseve rrugor dhe rrugëve të brendshme të fshatrave.

Pastrimi nga mbetjet inerte dhe vegjetacioni i kanaleve vaditës të fshatit Luzat, Kodër dhe Dukaj është detyrë e kryer nga punonjësit tanë në nisje të periudhës së vaditjes të tokave bujqësore.

Drejtorja e shërbimeve ka në dispozicion mjetet skrep dhe kamion për raste emergjencash dhe bllokime rrugësh nga rreshjet sidomos në periudhën e dimrit. Këto mjete në bashkëpunim me brigadat përkatëse ofrojnë shërbimin për të bërë të mundur zhbllokimin e rrugëve. Në ditët që nuk ka nevojë për ndërhyrje brigadat angazhohen në procese të ndryshme pune si pastrim territori dhe mirëmbajtje të fshatrave në njësitë administrative. Gjatë kësaj periudhe kemi bërë të mundur:

- Zhbllokimin e rrugës Bëncë-Progonat nga bllokimi me anë të mjeteve të rënda, 3 ditë pune.
- Pastrimin e kunetave në aksin Tepelenë-Bëncë (6,2km)
- Pastrimin e kunetave në aksin Bëncë-Progonat (15km)
- Pastrimin e kunetave dhe mirëmbajtjen e rrugës në aksin Dukaj-Sinanaj (17km)
- Pastrimin e kunetave në rrugën Hormovë (4,5km)
- Mirëmbajtja e rrugës Dukaj-Salari (8km).
- Mirëmbajtja e rrugës Salari-Kurvelesh (12km).
- Mirëmbajtja e rrugës Bence- Gusmar (18km).

2. Grumbullimi i mbetjeve.

Bashkia Tepelenë e kryen shërbimin e grumbullimit me vetëmenaxhim nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Publike bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligjin 8094/1996 “Për largimin publik të mbetjeve”; Ligjin 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”; Ligjin 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar.

Sipas censurit të vitit 2023 në Bashkinë Tepelenë banojnë rreth 10 471 banorë dhe sipas Gjendjes Civile banojnë 5569 familje. Gjendja infrastrukturore e rrugëve paraqitet e mirë pas investimeve të kryera vitet e fundit. Janë të aksesueshëm lehtësisht për shkak të rrugëve të asfaltuara 22 nga 24 fshatra të Njësisë Administrative, përveç fshatit Mezhgoran, Njësia Administrative Qendër (rruga në ndërtim e sipër) dhe fshatit Dorëz, Njësia Administrative Lopës.

Sipas disa të dhënave të ardhura nga studimet e kryera Bashkia prodhon rreth 6-7 ton mbetje/ditë, si rrjedhojë rreth 2500 ton/vit. Sasia e mbetjeve për banor është rreth 0.7kg/banor/ditë në qytet dhe 0.4kg/banor/ditë në zona rurale.

Venddepozitimi aktual i mbetjeve urbane ndodhet në Rrugën Nacionale Tepelenë-Tiranë, afër fshatit Majkosh, i cili ka një sipërfaqje prej 4900m², miratuar me VKB nr.7, datë 23.03.1998.



Venddepozitimi aktual i mbetjeve të ngurta inerte ndodhet në afërsi të rrugës Nacionale Tepelenë-Gjirokastrë, afër fshatit Luzat, sipërfaqje _____m², miratuar me VKB NR.5 DATE 31.01.2024

Bashkia Tepelenë kryen shërbimin e pastrim/grumbullim të mbetjeve urbane duke operuar me 2 brigada pastrimi.

Brigada e Njesisë Administrative Tepelenë, përbëhet nga 1 shofer dhe 2 punonjës, ka në dispozicion mjetin teknologjik 10ton, vepron sipas grafikut të miratuar 6 ditë/jave dhe mbulon Njësinë Tepelenë (Tepelenë, L.Demokracia, L.Gurëz) dhe Njësinë Qendër fshatrat lehtësisht të aksesueshëm në rrugët nacionale (Luzat, Bëncë, Veliqot, Majkosh, Dragot, Mezhgoran, Uji i Ftohtë). Brigada vepron sipas këtij grafiku të miratuar:

E HENE

Qytet(35) – L.Gurez(3) – L.Demokracia dhe rrethina (7) – Uji i Ftohte(5) – Stabilimenti(sipas kontrates).

E MARTE

Qytet(35)- L.Gurez(3)- L.Demokracia dhe rrethina(7)- Uji i Ftohte(5)- IEVP Bence (4)- Veliqot dhe aksi rrugor (10).

E MERKURE

Qytet(35)- L.Gurez(3)- L.Demokracia dhe rrethina(7)- Uji i Ftohte(5)-Aksi Mezhgoran -Ura e Leklit(12).

E ENJTE

Qytet(35)- L.Gurez(3)- L.Demokracia dhe rrethina(7)- Uji i Ftohte(5)-Aksi Nacional Mamaj-Tepelene(17).

E PREMTE

Qytet(35)- L.Gurez(3)- L.Demokracia dhe rrethina(7)- Uji i Ftohte(5)- Luzat(1)- Bence(4)- Stabilimenti (Sipas Kontrates).

E SHTUNE

Qytet(35)- L.Gurez(3)- L.Demokracia dhe rrethina(7)- Uji i Ftohte(5)- Aksi Mezhgoran-Ura e Leklit(12).

Brigada e Njësive Administrative Qendër, Kurvelesh dhe Lopës përbëhet nga 1 shofer dhe 1 punonjës, ka në dispozicion mjetin teknologjik 6ton dhe vepron sipas grafikut të përcaktuar 5 ditë/javë dhe mbulon Njësinë Lopës (Sinanaj, Dhëmban, Matohasanaj, Lab-Martalloz) Njësinë Kurvelesh(Lekdash, Progonat, Gusmar, Nivice, Rexhin) Njësinë Qendër(Salari, Dukaj, Turan, Hormove, Kodër, Mamaj, Becisht, Peshtan). Brigada punon sipas këtij grafiku të miratuar:



E HENE

Rruga 1. Nivice (15) - Gusmar (3)	TOTAL 18 konteniere 1.1 m ³
Rruga 2. Qytet (7) - Mamaj (4)	TOTAL 11 konteniere 1.1 m ³

E MARTE

Rruga 1. Progonat (16) - Lekdush (4)	TOTAL 20 konteniere 1.1 m ³
Rruga 2 . Dukaj (12)	TOTAL 12 konteniere 1.1 m ³

E MERKURE

Rruga 1. Njesia Administrative Lopes (14) – Salari(6)	TOTAL 20 konteniere 1.1 m ³
Rruga 2. Turan(9) - Rruga Dukaj-Smt (7)	TOTAL 16 konteniere 1.1 m ³

E ENJTE

Rruga 1. Hormove(13) -Subash (3)	TOTAL 16 konteniere 1.1 m ³
Rruga 2. Koder (6)- Dragoti (2)	TOTAL 8 konteniere 1.1 m

E PREMTE

Rruga 1. Peshtan(4)	TOTAL 4 konteniere 1.1 m ³
Rruga 2. Becishti(9)- Luzat (4)	TOTAL 13 konteniere 1.1 m ³


Ndryshimi i grafikut të mjeteve është kryer me qëllim rritjen e performancës dhe uljen e kostove ekonomike dhe kohore pas ndryshimeve të viteve të fundit ku kemi shtuar ofrimin e shërbimit në të gjithë njësitë administrative pas rehabilitimit të rrugëve të brendshme të fshatrave dhe aksesueshmërinë në të gjithë lagjet e tyre duke shtuar konteniere të mbetjeve urbane në të gjithë territorin urban si dhe rrugë nacionale interurbane.


Bashkia Tepelenë mbulon me shërbim pastrimi dhe grumbullimi **88%** të territorit që administron përvec fshatit Mezhgoran i sipërm(ofrohet pjesërisht), Dorëz(për shkak të mungesës së infrastrukturës), L.Kordhaj, Dukaj(mungesë infrastrukture) dhe fshatit Lekël. Në Njësinë Tepelenë janë të lokalizuar **71** konteniere , Njësinë Qendër **106** konteniere, Njësinë Lopës **14** konteniere dhe Njësinë Kurvelesh **38** konteniere duke e çuar numrin total të kontenierëve të shpërndarë në territorin e Bashkisë Tepelenë në **229**. Gjithashtu kemi shpërndarë dhe **60** kosha metalikë me këmbalecë në territorin e Njësisë Administrative Tepelenë të cilët kanë ardhur nga FSHZH në vijim të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Bashkinë Tepelenë.


Për mbetjet e ngurta inerte, mbetjet voluminoze dhe mbetjet e gjelbërta të krijuara nga krasitjet e pemëve dhe pastrimet Bashkia Tepelenë ka në dispozicion mjetin me karroceri Tip Kamion .

Mbetjet e tjera të metalike, vajrat, bateritë etj. trajtohen nga firma private larg territorit të Bashkisë Tepelenë.

Më poshtë paraqesim hartën e shpërndarjes së kontenierëve në Njësinë Tepelenë, Qendër, Kurvelesh dhe Lopës.







3. Shërbimi publik i varrimit dhe mirëmbajtja e varrezave publike.

Mirëmbajtja e varrezave publike si një prej asetëve të Bashkisë Tepelenë është një detyrë që kryhet në përditshmëri nga punonjësit tanë. Në Njësinë Administrative Tepelenë janë të lokalizuar 2 varreza publike, varrezat Tepelenë dhe varrezat Majkosh. Gjatë kësaj periudhe kemi kryer këto ndërhyrje në varrezat Tepelenë:

- Korrje dhe pastrim i barërave dhe mirëmbajtje javore e tyre sipërfaqje **6750 m2**.
- Restaurim i cezmave publike dhe rrjetit ujësjiellës.
- Restaurim dhe ndërtim muri rrethues me pamje lindore dhe juglindore.
- Nisja e punës për rrethim të ri dhe ndërtim të mureve rrethues me pamje jugore, jugperëndimore dhe jugore.
- Nisja e punës për rikonstrukcion të rrugëve të brendshme.
- Nisja e punës për restaurim të Portës së Varrezave.

Në varrezat publike Majkosh kemi kryer ndërhyrje në:

- Korrje dhe pastrim i barërave dhe mirëmbajtje me frekuencë javore, sipërfaqja e varrezave **10,500m2**.
- Shtrim i rrugës së jashtme me cakull (rrugë e bardhe) me gjatësi **250 ml**.
- Restaurimi cezmave publike dhe i rrjetit ujësjiellës.

Për sa i përket Njesisë Administrative Qendër Tepelenë kemi bashkëpunuar me Administratorin në mirëmbajtje si korrje dhe pastrim të këtyre varrezave gjatë nisjes së sezonit veror:

- Varrezat Hormovë (2 varreza) me sipërfaqje **16,500m²**.
- Varrezat Peshtan me sipërfaqje **3000m²**.
- Varrezat Lekël me sipërfaqje **1200m²**.
- Varrezat Kodër me sipërfaqje **2300m²**.
- Varrezat Becisht me sipërfaqje **2000m²**.
- Varrezat Mezhgoran(2 varreza) me sipërfaqje **2500m²**.
- Varrezat Dragot me sipërfaqje **4000m²**.
- Varrezat Bence (2 varreza) me sipërfaqje totale **2600m²**.
- Varrezat Dukaj (3varreza) me sipërfaqje **23000m²**.
- Varrezat Luzat me sipërfaqje **2200m²**.
- Varrezat Veliqot me sipërfaqje **4000m²**.

Në Njësinë administrative Lopës dhe Kurvelesh për shkak të distancës brigada e shërbimeve punon nën administrimin e Administratorit të Njesisë i cili planifikon punën në bazë të nevojave të Njesisë ku përfshihen pastrim, mirëmbajtje rruge dhe mirëmbajtje varrezave. Punët që kërkojnë ndërhyrje të specializuar mbulohen nga punonjësit e shërbimeve të Drejtorisë. Për sa i përket mirëmbajtjes së varrezave publike Njësia Lopës numëron rreth **43,640m²** sipërfaqje për mirëmbajtje në fshatrat Lab-Martalloz, Dorëz, Dhëmban, Matohasanaj dhe Sinanaj. Ka nisur puna në rrethimin e varrezave në lagjen Dashaj me punonjësit e brigadës, ndërsa korrja kryet sipas planit tëpërcaktuar nga Administratori i Njesisë.

Njësia Kurvelesh numëron rreth **35,000m²** sipërfaqje të varrezave publike për mirëmbajtje dhe ky proces kryhe nga brigada nën mbikqyrjen e strukturës së Administratorit të Njesisë.

4. Gjelbërim – Dekor dhe sipërfaqjet e gjelbëruara.

Gjelbërimi i qytetit, mirëmbajtja dhe shtimi i sipërfaqjeve publike është një nga proceset e punës që i është dhënë përparësi këtë periudhë në vijimësi të planit për zgjerimin e hapësirave të gjelbëruara të nisura vitin e kaluar. Kemi vijuar me shtimin e sipërfaqjeve të gjelbërta në Njësinë Administrative Tepelenë në të cilat kemi trajtuar rrënjësisht duke pastruar, ndërtuar bordura dhe kufizime si dhe trajtuar me lëndë të parë për rikuperimin e tyre.Kemi trajtuar këto lulishte të reja në qytet Tepelenë:

- Unaza Veriore, ritrajtim i lulishtes egzistuese. **600m²**.



- Rruga Ali Pashë Tepelena, Hyrja veriore e kalasë, pranë bustit të Selam Musait, ritrajtim i lulishtes. Sip. Totale **140m²**.
- Xhamia e Qytetit, l.15 Shtatori, trajtim i 3 lulishteve egzistuese. Sip. Totale **270m²**.
- Kalceto e Qytetit, l.15 Shtatori, ndërtim i 2 lulishteve të reja. Sip. Totale **170m²**.
- Rr. Batalioni Baba Abaz, ritrajtim i lulishteve egzistuese. Sip. Totale **90m²**.
- Rr. Shullaz, pranë Ish KESH, ndërtim i 4 lulishteve të reja. Sip. Totale **80m²**.
- Rr. Myfyt Hasa, ndërtim i lulishtes së re. Sip. Totale **70m²**.
- Rr. Tafil Buzi, mbrapa muzeut të qytetit, ndërtim lulishte të reja. Sip. Totale **25m²**.
- Rr. Lbilda, pranë pallatit të ri, ritrajtim lulishte egzistuese. Sip. Totale **25m²**.
- Rr. Nacionale Tepelenë-Tiranë, pranë varrezave publike, lulishte të reja. Sip. Totale **400m²**.
- Rr. Unaza Veriore, ndërtim 2 lulishte të reja. Sip. totale **50m²**.
- Rr. Bilbilenjtë, ndërtim 2 lulishte të reja. Sip. Totale **90m²**.
- Kopështi Murat Kociu, ritrajtim i lulishtes egzistuese. Sip. Totale **520m²**.

Aktualisht në Njësinë Tepelenë trajtojmë një sipërfaqje të gjelbërt prej **13,470 m²** të cilat mirëmbahen rregullisht me të gjithë proceset e nevojshme sipas stinëve. Gjatë sezonit dimëror mbi këto sipërfaqje kemi kryer rregullisht krasitjen e pemëve dhe hedhjen e plehut kimik me 2 faza, gjithashtu dhe rimbjelljen me farë bari në lulishtet ku ka pasur nevojë. Gjatë aksionit të mbjelljeve kemi kryer mbjelljen e **280** shkurre dekorative (trëndafila, olenadër) në Njësinë Administrative Tepelenë dhe gjithashtu kemi mbjellë **210** pemë të mëdha (bli, rrep, ilqe, pisha) në të gjithë Njësitë Administrative Tepelenë, Lopës, Kurvelesh, Qendër. Këto pemë kanë ardhur në Bashkinë Tepelenë në vijimësi të marrëveshjes me FSHZH për plotësim me lëndë të parë me qëllim përmirësimin e territorit publik.

Në vijim të sezonit pranveror ka vijuar korrja e sipërfaqjeve të gjelbërta në Njësinë Tepelenë. Me nisjen e verës dhe nevojën për vaditje kemi bërë të mundur ndërtimin e 5 Pikë lidhjeve të reja me UKT për vaditje të lulishteve në brendësi të pallateve nga ku trajtojmë **90%** të lulishteve egzistuese. Pjesa e mbetur do të trajtohet sezonin e ardhshëm për shkak të vështirësive teknike për krijimin e pikëlidhjeve. Theksojmë se zgjerimi i hartës për mirëmbajtje nga ana e punonjësve tanë rrit nevojën për shtim të burimeve njerëzore nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.



5. Ndricimi Publik, mobilimi urban dhe ndërhyrjet restauruese në asete publike.

Gjatë kësaj periudhe fokus i shërbimeve ka qenë dhe ndërhyrja në ndricimin publik të të gjitha Njësi Administrative. Në Njësinë Tepelenë që mbulon qytetin dhe rrethinat mirëmbajmë nga difektet dhe në përditshmëri rrjetin furnizues rrugor dhe kujdesemi për riparimin dhe zëvendësimin e prozhektorëve. Kemi kryer riparime dhe ndërhyrje në:

- Rrugën “Batalioni Baba Abaz”
- Lagjen Demokracia
- Lagjia Fermë
- Rruga “Dëshmorët e Lirisë”
- Rruga “Lbilta” dhe L.Mustafa Matohiti
- Rruga “Shullaz” dhe L.Selam Musai
- Rruga “Ali Pashë Tepelena” aksi Kalaja-Busti “Selam Musait” në të cilën kemi kryer restaurim total të linjës rrugore dhe prozhektorëve me një gjatësi rreth **200ml**.
- Hyrja veriore e Kalasë dhe territori përreth bustit të “Selam Musait” në të cilën kemi kryer restaurim total të linjës dhe prozhektorëve.
- Rruga “Shaban Lamaj” që lidh qytetin me Njësitë administrative kemi shtuar ndricim me shtylla të reja me një gjatësi rreth **260ml**.




Në njësinë Administrative Qendër Tepelenë kemi kryer restaurim, sistemime dhe mirëmbajtje në ndricimit publik në të gjithë fshatrat e Njësisë ku kemi mbuluar qendrat e fshatit, rrugët interurbane dhe rrugët e brendshme të fshatit. Ndërhyrjet janë fokusuar në fshatrat:

- Mamaj
- Dukaj
- Veliqot
- Turan
- Hormovë
- Lekël
- Kodër
- Mezhgoran i sipërm dhe Luadh, ku është ndërhyrë pas një kohë të gjatë për shkak të infrastrukturës rrugore.
- Becisht
- Dragot
- Salari
- Peshtan
- Në Lagjen Kordhaj të fshatit Dukaj kemi ndërhyrë me vendosjen e ndricuesve fotovoltaike me panel diellor.
- Në fshatin Bëncë dhe Luzat në vijimësi të bashkëpunimit me FSHZH është bërë e mundur vendosja e ndricuesve fotovoltaike diellor në rrugët e fshatit.

Në njësinë Kurvelesh ne vijimësi të bashkëpunimit me FSHZH është bërë e mundur vendosja e paneleve fotovoltaike në fshatrat Lekdush, Progonat, Nivicë dhe Gusmar dhe po punohet për sistemimin e ndricimit në brendësi të fshatrave.

Në Njësinë Lopës ndricimi ka pas probleme për shkak të terrenit por planifikojmë ndërhyrje dhe përfundim të punës brenda muajit gusht.

Gjatë kësaj periudhe kemi shpërndarë në total rreth **220** stola në qytet dhe Njësi Administrative si pjesë e planit të punës për mobilim urban të hapësirave publike.



Ndërhyrjet në restaurimin e aseteve publike në qytet Tepelenë dhe në Njësi Administrative:

- Vendosje hekurash mbajtes dhe kufizues ne Unazen veriore.
- Riparim i stolave ne Pedonalen e qytetit.
- Restaurim i gurëve të pedonales “Ali Pashë Tepelena”
- Riparim rrjetit KUZ në fshatin Veliqot, Njësia Administrative Qendër.
- Riparim rrjetit KUZ ne lagjen Mustafa Matohiti (posta), Rr.Bilbilenjtë, Rr “Ali Pashë Tepelena”
- Riparim dhe mirëmbajtje të shatërvaneve publik ish Tregu, pranë Bashkisë dhe “Valltarët” dhe “Guri” në Unazën Veriore.
- Pastrim nga vegjetacioni I mureve të kalasë së Ali Pashës.
- Riparim në Kalceton dhe pallatin e sportit.
- Vendosje police të shtrirë në Rr”Batalioni Baba Abaz”, Rr.”Shullaz”, Rr. “Bilbilenjtë”, Rr “Lbilta”.
- Ndërhyrje riparuese ne catinë dhe murin mbajtës të shkollës Dukaj, Riparime në shkollën “7 Marsi” Tepelenë dhe godina e Njesisë Kurvelesh, fshati Gusmar.
- Riparim i cezamve publike në fshaatin Dukaj, Peshtan dhe Dhëmban.
- Restaurim Ura e Varur Hormovë.
- Kemi kryer rindërtimin dhe restaurimin e **1200m2** mure mbajtës dhe bordura kufizuese në vijimësi të procesit për përmirësim të sipërfaqjeve të gjelbëruara dhe hapësirave publike.
- Kemi kryer rrethim dhe sistemim të Vendgrumbullimit të inerteve në Fushë-Luzat.
- Kemi kryer restaurim të kangjellave dhe hekurave të jashtëm të Kopështit “Murat Kociu”.



- Rikonstruksion total të Lapidarit Hormovë.
- Rikonstruksion total dhe veshje me pllaka guri Lapidari Mezhgoran .
- Rikonstruksion total Lapidari Gusmar.
- Rikonstruksion total Lapidari dhe Cezma Lekdush.
- Rikonstruksion total Lapidari “Lisi i Kadhe” Kurvelesh.
- Rikonstruksion total Lapidari Rexhin.
- Rikonstruksion total Varrezat e Dëshmorëve Progonat.
- Rikonstruksion Bustet “3 Heronjtë” dhe Pallati i Kulturës Tepelenë.
- Rifreskim dhe lyerje Monumenti Subash.
- Lyerje të pllakadave “Lord Bajron”, Busti “Nimete Progonati”, “Selam Musai”

6. Akset rrugore, Ndërtimtaria dha mirëmbajtja.

Procesi i ndërtimitarisë së rrugëve interurbane dhe të brendshme sidomos në Njësi Administrative është kryhet në saj të marrëveshjeve me FSHZH dhe Qeverinë Shqiptare si dhe disa kryhen me financat e Bashkisë. Gjatë kësaj periudhe ka pasur një rritje të konsiderueshme të kryerjes së punimeve ndërtimorë në lidhje me akset rrugore të cilat po jua vendosim në dispozicion më poshtë:

- L.Demokracia,rrugët e brendshme, Rrugë e bardhë, Total **1100ml.**
- Rruga e varrezave Majkosh, Rrugë e bardhë , **250ml.**
- Rrugë e brendshme Kodër, Rrugë e bardhë, **2200ml,**
- Rruga e fshatit Kodër, Asfaltim, **1000ml.**
- Rrugë e brendshme dhe rruga e fshatit Mezhgoran, Rruga e Bardhe, Total **5000ml**
- Rrugë e fshatit Matohasanaj, Rruga e Bardhë, Total **4000ml.**
- Rrugët e brendshme Kordhaj, Rrugë e Bardhë, Total **2250ml.**
- Rruga e brendshme Dukaj, Shtrim me beton, Total **2200ml.**
- Rrugë e brendshme Velipot, Shtrim me beton, Total **630ml.**
- Rrugë e fshatit Luzat, Asfaltim, Total **1000ml.**
- Rruga e brendshme Tepelenë, Corodol , Shtrim me beton. Total **700ml.**
- Rruga e brendshme Mamaj, Rruga e Bardhe, Total **520ml.**
- Rruga Unaza Turan, Hapje trasheje, **1200ml.**
- Rruga e brendshme fshati Bence, Shtrim me beton. Total **150ml.**
- Rruga e brendshme Lekdush, Shtrim me beton.Total **40ml.**
- Rruga e brendshme Hormove,Shtrim me beton. Total **350ml.**
- Rruga e brendshme Peshtan, Shtrim me beton. Total **600ml.**
- Rruga e brendshme Dragot, Shtrim me beton. Total **220ml.**
- Rruga “Myfyt Hasa” Tepelenë, Asflatim. Total **250ml.**
- Rruga e brendshme Becisht, Shtrim me beton. Total **400ml.**
- L.”Mustafa Matohiti”, rruga pranë kopështit “Murat Kociu” , Shtrim me beton te stampuar. Total **500m2.**

Për Drejtorinë e Shërbimeve Publike

DREJTORI

Adi Vela